

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Isa Kelmendi, kryetar, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit M. A. nga ..., të cilin e përfaqëson J. R., av. nga ..., kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës, sh.a. Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe kthimit në punë si dhe kompensimit të të ardhurave personale, duke vendosur lidhur me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1248/18 datë 13.2.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më 11.7.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1248/18 datë 13.2.2019.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.1248/18 datë 13.2.2019, është aprovuar si e bazuar ankesa e të paditurës dhe është ndryshuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.779/15 datë 11.12.2017, ashtu që është refuzuar kërkesëpadia e paditësit M. A. nga ..., me të cilën ka kërkuar që të anulohet si i kundërligjshëm njoftimi-vendimi i të paditurës nr. ..., me të cilin paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si dhe vendimi i të paditurës KEK-Divizioni i Rrjetit 01 në Prishtinë, me nr. ..., i datës 7.12.2010, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit e parashtruar kundër njoftimit-vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe që të detyrohet e paditura që paditësin M. A., ta kthejë në punë në detyrat e punës në përputhje me kualifikimet që i ka ai me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës si dhe t'ia kompensojë pagat për periudhën që paditësi nuk ka punuar në shumën e parave prej 24.192,48 €, me kamatë ligjore në shumën prej 3.686,94 €, kurse në emër të shpenzimeve procedurale t'ia paguaj shumën e tërësishme në lartësi prej 540 €, të gjitha këto brenda afatit prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë, tërësisht si e pabazuar.

Kundër aktgjykimit të lartpërmendur të gjykatës së shkallës së dytë, paditësi në afat ligjor ka paraqitur revizion për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që revizioni i paditësit të aprovohet si i bazuar ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i goditur dhe të mbetet në fuqi aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.779/15 datë 11.12.2017.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 215 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtoi aktgjykimin e goditur me revizion dhe gjeti se:

Revizioni i paditësit, është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi sipas kontratës së punës të lidhur me të paditurën nr. ..., datë 1.9.2010 ka themeluar marrëdhënie pune në kohë të pacaktuar në vendin e punës – elektrikist në kujdestari – distrikti Ferizaj. Me rastin e kontrollit nga punëtorët e autorizuar të paditurës është vërtetuar se paditësi ka bërë shfrytëzimin e energjisë elektrike pa të drejtë në atë mënyrë që në shtëpinë e vet kabllon kryesore e ka lidhur me siguresën kryesore dhe e njëjta lidhje është lidhur edhe kabllot që furnizon shtëpinë me energji elektrike duke e anashkaluar njehsorin elektrik, ashtu që energjia e shpenzuar fare nuk është regjistruar në njehsorin sipas normave të KEK-ut. Për këtë arsye menaxheri i të paditurës pas intervistimit të paditësit ia dorëzon njoftimin për shpërbërjen e kontratës së punës nr. ..., datë 26.11.2010 për shkak të shkeljeve të lartpërmendura të detyrave të punës të cilat janë kualifikuar si sjellje e rëndë e keqe-vjedhje, shkatërrim, dëmtim ose shfrytëzim i paautorizuar i pasurisë së punëdhënësit dhe si sjellje e natyrës së punës tepër të rëndë pas së cilës do të ishte e paarsyeshme që të pritet vazhdimi i marrëdhënies së punës edhe më tej të paraparë me nenin 11.3 pika (b) dhe (d) të Ligjit themelor të punës në Kosovë dhe me nenin 8.14 nënpika (a) të Rregullores së punës për distriktet në KEK. Kundër këtij njoftimi për shpërbërje të kontratës së punës, paditësi ka paraqitur kundërshtim i cili është refuzuar si i pabazuar me vendimin e Drejtorit të Divizionit të rrjetit nr. 6275 datë 7.12.2010. Me datë 16 dhjetor 2010, paditësi me padi ka kërkuar mbrojtje gjyqësore të drejtave të tij nga marrëdhënia e punës. Kundër paditësit për veprimet e përshkuara më lartë është udhëhequr edhe procedura penale për veprën penale të vjedhjes nga neni 252 par. 1 të KPK-së dhe me aktgjykim të Gjykatës Themelore në Ferizaj, P.nr.787/10 datë 17.4.2014 është shpallur fajtor dhe është dënuar me gjobë, i cili aktgjykim është vërtetuar me aktgjykim të Gjykatës së apelit të Kosovës, PA.1.nr.1206/2014 të datës 23.11.2015.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, gjykata e shkallës së parë ka gjetur se është e paligjshme shkëputja e kontratës së punës në mes të paditësit dhe të paditurës pasi që për shkeljet e lartpërmendura e paditura nuk ka zhvilluar procedurë disiplinore kundër paditësit edhe pse ligjërisht ka qenë e detyruar për zhvillimin e asaj procedure, andaj për këtë arsye ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur në tërësi si në dispozitivin e aktgjykimit të saj.

Gjykata e Apelit në Prishtinë, në procedurën ankimore ka pranuar si të bazuar ankesën e të paditurës dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ashtu që kërkesëpadinë e paditësit e ka refuzuar si të pabazuar, me arsyetim se me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit gabimisht është zbatuar e drejta materiale, pasi që veprimet e të paditurës përkitazi me ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit janë veprime tërësisht të ligjshme në pajtim me nenin 11 par. 1 pika (c) të Rregullores nr. 2001/27 për Ligjin themelor të punës në Kosovë lidhur me nenin 11 par. 3 pika (b) e cila i referohet shkeljes së rëndë të detyrave të punës për shkak të vjedhjes, shkatërrimit, dëmtimit ose shfrytëzimit të paautorizuar të pasurisë së punëdhënësit.

Në një gjendje të tillë të çështjes, Gjykata Supreme e Kosovës pranon si të bazuar qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë lidhur me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit pasi që i njëjti aktgjykim nuk përfshihet me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore në të cilat Gjykata e revizionit në kuptim të nenit 215 të LPK-së, kujdeset sipas detyrës zyrtare e as me zbatim të ga buar të së drejtës materiale. Gjykata Supreme pranon si të bazuara të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së dytë të dhëna në arsyetimin e aktgjykimit të saj.

Për më tepër, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin për të kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit lidhur me zbatimin e të drejtës materiale për faktin se është i drejtë konstatimi i gjykatës së shkallës së dytë se e paditura i ka respektuar procedurat e përcaktuara me Rregullores e UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të punës në Kosovë, ashtu që në bazë të nenit 11.5 për shkeljet e rënda të përcaktuara në nenin 11.2 e të njëjtit Ligj, paditësi është njoftuar me njoftimin nr. 1063 datë 26.11.2010 për qëllimin e saj për t'ia ndërprerë paditësit kontratën e punës në bazë të pikës (b) , e paditura ka mbajtur takim me paditësin me ç'rast i ka shpjeguar gojarisht për shkëputjen e kontratës së punës. E paditura ka zhvilluar procedurat interne të bazuara për rregulloret e operacioneve të

distrikteve të KEK-ut nr. 3 të datës 30 nëntor 2009 e cila është në tërësi në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit themelor të punës në Kosovë, Rregullorja nr. 2001/27.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate në rastin konkret, e paditura me rastin e shkëputjes së kontratës së punës së paditësit, ka përfillur në tërësi procedurën e përcaktuar ligjore të paraparë pasi që shkeljet e detyrave të punës nga paditësi janë vërtetuar në mënyrë të sigurve e për të cilat i njëjti është shpallë fajtor edhe në procedurën penale, për të cilën arsye është mbajtur takimi me paditësin, është njoftuar për qëllimin e të paditurës që paditësit do t'i shkëputet kontrata e punës për shkak të këtyre shkeljeve. Vendimi mbi shkëputjen e kontratës së punës është marrë nga organi kompetent drejtori menaxhues në pajtim me Rregulloren interne të paditurës më lartë të përmendur, pasi që në mënyrë të sigurve janë vërtetuar shkeljet disiplinore të paditësit. Për më tepër, nga provat e administruara në gjykatën e shkallës së parë, paditësi nuk ka arritur të provojë të kundërtën e fakteve të gjetura te punëdhënësi, prandaj edhe Gjykata e revizionit vlerëson se shkëputja e kontratës së punës së paditësit nuk përfshihet me paligjshmëri kështu që pretendimet e paditësit në revizion, se gjykata e shkallës së dytë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale për shkak të mospërfilljes së procedurës së përcaktuar ligjore me rastin e shkëputjes së kontratës së punës, janë të papranueshme për arsyet e dhëna më lartë.

Për arsyet e paraqitura më lartë, me zbatimin e nenit 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

Rev.nr. 212/2019 datë 11.7.2019

Kryetari i kolegjit,

Isa Kelmendi